

REGJISTRI KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE - NËNTOR 2025

NR. RENDOR	DATA E KËRKESËS	OBJEKTI I KËRKESËS	DATA E PËRGJIGJES	PËRGJIGJE	MËNYRA E PËRFUNDIMIT TË KËRKESËS	TARIFA
1	03.11.2025	Kërkesë për vënie në dispozicion të informacionit nëse leja e ndërtimit me kusht,miratuar me vendimin.....,ka përfunduar procedurën e konfirmimit dhe a është miratuar apo jo	10.11.2025	Në përgjigje të shkresës suaj...,Ju sqarojmë se: Sikurse ju kemi bërë me dije edhe në korrespondencat e mëparshme vendimi.....,nuk është zbardhur ende. Për sa më sipër,pas përfundimit të procesit të zbardhjes, vendimi....së bashku me dokumentacionin që e shoqëron atë,do të mund t'a aksesoni në faqen web të AZHT-së www.azht.gov.al .	E plotë	Nuk ka
2	03.11.2025	Kërkesë për informacion	11.11.2025	Në përgjigje të shkresës Suaj.....,ju bëjmë me dije si më poshtë vijon: AZHT, e cila aktualisht funksionon si Sekretariat Teknik i KKTU-së, në mbështetje të Vendimit Nr.725,datë 02.09.2015 "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të AZHT",i ndryshuar, ka kompetencë <i>pranimin,përgatitjen dhe administrimin e dokumentacionit që shqyrtohet dhe miratohet në mbledhjet e KKTU-së.</i> Në vijim,nga verifikimi..në databazën e institucionit tonë,nuk rezultoi të ketë aplikim për leje zhvillimi/ndërtimi mbi pasuinë....., e për rrjedhojë nuk ka as vendimmarrje nga ana e KKTU.	E plotë	Nuk ka
3	03.11.2025	Disponimin e dokumentacionit hartografik që shoqëron Vendimin e KKTU nr.....	14.11.2025	Në përgjigje të kërkesës suaj...,lutemi gjeni bashkëlidhur: -Vendimin nr..... Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,mbetemi në dispozicion për çdo informacion të nevojshëm	E plotë	Nuk ka
4	04.11.2025	Kërkesë	20.11.2025	Në përgjigje të shkresës Suaj.....,ju bëjmë me dije se: Të gjitha vendimet e zbardhura të Këshillit Kombëtar të Territorit (sot KKTU), i gjeni të publikuara në faqen zyrtare të AZHT: https://azht.gov.al ,në rubrikën "Vendime KKTU".	E plotë	Nuk ka

5	10.11.2025	Kërkesë	21.11.2025	Në përgjigje të kërkesës suaj...,Ju bëjmë me dije se: lutemi Vendimarrja e Këshillit Kombëtar të Territorit(sot KKTU) me nr.....,prek vetëm pasurinë.... Në vijim sqarojmë se pjesë e dokumentacionit ligjor të depozituar është dhe plani i organizimit të punimeve i cili përfshihet brenda kufirit të pronës,të cilën e gjeni bashkëlidhur. Mbetemi në dispozicion për çdo informacion të nevojshëm.	E plotë	Nuk ka
6	10.11.2025	Kërkesë për informacion nëse është marr leje zhvillimi,leje ndërtimi apo është lëshuar dokumenti i lejes për aplikimin e paraqitur nga.....	02.12.2025	Në përgjigje të shkresës suaj....ju sqarojmë si më poshtë vijon: KKTU në mbledhjen..ka miratuar Vendimin....në përputhje me Ligjin Nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit",i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Vendimi i sipërcituar nuk është zbardhur.Sapo ky vendim të zbardhet së bashku me hartën që i bashkëlidhet,do të publikohen (në mënyrë që të jenë të aksesueshme për të gjithë subjektet,ashtu sikurse të gjithë Vendimet e tjerë të KKTU),në adresën zyrtare të AZHT: http://www.azht.gov.al,në rubrikën "Vendime KKTU".	E plotë	Nuk ka
7	12.11.2025	Kërkesë për informacion nëse subjekti..... ka aplikuar për leje ndërtimi pranë institucionit tuaj	14.11.2025	Në lidhje me kërkesën Tuaj dërguar nëpërmjet adresës elektronike, ju bëjmë me dije se nga verifikiminë databazën e Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, për shoqërinë ..., është depozituar nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, aplikimi protokolluar pranë AZHT-së, ku përfshihet .., në pasurinë, për të cilin nuk ka vendimarrje nga ana e Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit.	E plotë	Nuk ka
8	12.11.2025	Kërkesë për informacion nëse subjekti..... ka aplikuar për leje ndërtimi pranë institucionit Tuaj.	14.11.2025	Në lidhje me kërkesën Tuaj dërguar nëpërmjet adresës elektronike, ju bëjmë me dije se nga verifikimi. në databazën e Agjencisë së Zhvillimit të Territorit , për shoqërinë, është depozituar nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, aplikimi protokolluar pranë AZHT-së, ku përfshihet, në pasurinë, për të cilin nuk ka vendimarrje nga ana e Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit.	E plotë	Nuk ka
9	12.11.2025	Kërkesë për informacion	02.12.2025	Në lidhje me kërkesën Tuaj dërguar nëpërmjet adresës elektronike, lutemi gjeni këtu bashkëlidhur përgjigjen në lidhje me kërkesën Tuaj, e cila është përcjellë dhe në rrugë zyrtare nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit.	E plotë	Nuk ka

10	12.11.2025	Kërkesë për sqarim ligjor dhe procedural në lidhje me aplikimin për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi në zk....	05.12.2025	Në përgjigje të shkresës suaj..ju bëjmë me dije se: AZHT, e cila aktualisht kryen funksionet e Sekretariatit Teknik të KKTU-së,është krijuar me Vendimin Nr.725,datë 02.09.2015 "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të AZHT",i ndryshuar. Në mbështetje të VKM-së sipërcituar, kjo Agjenci ka kompetencë pranimin,përgatitjen dhe administrimin e dokumentacionit që shqyrtohet në mbledhjet e KKTU,me qëllim miratimin e lejeve të zhvillimit/ndërtimit nga KKTU. Në vijim ju bëjmë me dije se,përgjegjësitë dhe detyrat që i janë ngarkuar për zbatim specifikisht AZHT-së,përcaktohen shprehimisht në pikën III,të VKM-së Nr.725 datë 02.09.2015 "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të AZHT",e ndryshuar.Ndërkohë,interpretimi i dispozitave ligjore nuk është në fushën e përgjegjësisë së institucionit tonë. Në vijim sqarojmë se,dokumentacioni që administrohet nga an e AZHT-së për çdo aplikim që paraqitet pranë tij në sistemin e-leje,vjen në përputhje me dispozitat e VKM-së Nr.408,datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të terriotrit"(i ndryshuar), ku parashikohet në mënyrë të detajuar i gjithë dokumentacioni tekniko-ligjor që duhet të paraqesin aplikuesit për miratimin e lejeve të zhvillimit,konkretisht Neni 10 "<i>Dokumentacioni për pajisje me leje zhvillimi</i> " ku ndër të tjera dokument themelor përmendet "<i>dokument që vërteton të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në zhvillim dhe nëse ka,kopje të marrëveshjes për pronën;... </i>"(pika 1,shkronja"c"). Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,mbetemi në dispozicion për çdo informacion të nevojshëm.	E plotë	Nuk ka
----	------------	--	------------	--	---------	--------

11	14.11.2025	Kërkesë për anulimin e Lejes së ndërtimit.....	27.11.2025	Në përgjigje të shkresës Suaj...,Ju sqarojmë si më poshtë vijon; AZHT, aktualisht funksionon si Sekretariat Teknik i KKT, në mbështetje të Vendimit Nr.725,datë 02.09.2015 "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të AZHT",i ndryshuar,ka kompetencë pranimin,përgatitjen dhe administrimin e dokumentacionit që shqyrtohet dhe miratohet në mbledhjet e KKTU. Referuar shkresës suaj sqarojmë se,për sa i përket Lejes së Ndërtimit.....,bazuar në Ligjin Nr.107/2014 "Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar,në Nenin 7/2 ku përcaktohen "Përgjegjësitë e sekretariatit teknik të KKTU-së" Ju bëjmë me dije se nuk është kompetencë e AZHT të kryejë veprime për pezullim apo verifikim të procedurës së dhënies së lejeve të lëshuara nga institucione të tjera. Për sa më sipër,nga verifikimet e kryera nuk rezulton që ju të jeni pronarë të pasurive pjesë e projekt-propozimeve të sipërcituara.Ndërsa për sa i përket Lejes së Ndërtimit të miratuar nga Bashkia...,lutemi t'i drejtoheni këtij institucioni në lidhje me kërkesat tuaja. Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,mbetemi në dispozicion për çdo informacion të nevojshëm.	E plotë	Nuk ka
12	17.11.2025	Kërkesë për informacion mbi PDV në njësinë strukturore.....	18.11.2025	Shënim: Në zbatim të Nenit 24, pika 1 të Kodit të Procedurave Administrative ku përcaktohet se: “Kur një organ publik merr një kërkesë,për një çështje që e vlerëson jashtë kompetencës së vet,ia përcjell kërkesën menjëherë,organit publik kompetent dhe njofton kërkuuesin për këtë”, kërkesa është përcjell në organin publik kompetent,ku dhe kërkuesi është vendosur në dijeni për këtë.	E plotë	Nuk ka
13	17.11.2025	Kërkesë për informacion	27.11.2025	Në përgjigje të shkresës Suaj...,Ju bëjmë me dije si më poshtë: AZHT është zgjedhur në sistemin e-leje për dhënie mendimi për kërkesën..... Për sa më sipër,pas përcjelljes së kërkesës nëpërmjet sistemit elektronik e-lejet,AZHT nuk ka marrë asnjë përgjigje..... Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin, mbetemi në dispozicion për çdo informacion të nevojshëm.	E plotë	Nuk ka

14	19.11.2025	Shënim : kërkesë pa objekt	11.12.2025	Shënim :Në zbatim të Nenit 24, pika 1 të Kodit të Procedurave Administrative ku përcaktohet se: “Kur një organ publik merr një kërkesë,për një çështje që e vlerëson jashtë kompetencës së vet,ia përcjell kërkesën menjëherë,organit publik kompetent dhe njofton kërkuuesin për këtë”, kërkesa është përcjell në organin publik kompetent,ku dhe kërkuesi është vendosur në dijeni për këtë.	E plotë	Nuk ka
15	21.11.2025	Kërkesë për marrje të kontratës së Sipërmarrjes të lidhur me....	27.11.2025	Në përgjigje të shkresës tuaj...ju bëjmë me dije se: AZHT, e cila aktualisht funksionet e Sekretariat Teknik i KKTU-së,është krijuar me Vendimin Nr.725,datë 02.09.2015 "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të AZHT",i ndryshuar. Në mbështetje të VKM-së sipërcituar, kjo Agjenci ka kompetencë pranimin,përgatitjen dhe administrimin e dokumentacionit që shqyrtohet në mbledhjet e KKTU,me qëllim miratimin e lejeve të zhvillimit/ndërtimit nga KKTU. Në vijim ju sqarojmë se,gjatë shqyrtimit të aplikimeve për leje zhvillimi/ndërtimi,AZHT nuk kryen verifikimin e origjinës së pronës,mënyrës së regjistrimit të saj,bazuar në Nenin 4 paragrafi 2 të VKM-së 408/2015 <u>"....Autoriteti i zhvillimit nuk mund të kërkojë vërtetime nga personi i interesuar lidhur me vërtetësinë apo autenticitetin e këtyre dokumenteve apo të dhënave"</u>, por konsiderohen të rregullta dhe konform legjislacionit në fuqi,dokumentacioni i pronësisë që disponohet nga ASHK, apo Drejtoritë Vnodore të saj,të cilat janë autoriteti kompetent për lëshimin e tyre duke ngarkuar dhe me përgjegjësi nga legjislatori,për veprimet apo mosveprimet e tyre. Sa më sipër,duke mirëkuptuar shqetësimin tuaj,nëse gjatë kësaj periudhe do të ketë vendim të formës së prerë nga ana e gjykatës kompetente apo vendim të ndërmjetëm për kufizimin/vendosjes e masës së sigurimit të padisë mbi pasurinë objekt zhvillimi,lutem të na e vendosni në dispozicion. Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,mbetemi në dispozicion për çdo informacion të nevojshëm.	E plotë	Nuk ka

16	21.12.2025	Kërkesë për informacion/hetim administrativ	02.12.2025	Në përgjigje të shkresës suaj..ju sqarojmë: AZHT, e cila aktualisht funksionon si Sekretariat Teknik i KKTU-së,në mbështetje të Vendimit Nr.725,datë 02.09.2015 "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të AZHT",i ndryshuar, ka kompetencë pranimin,përgatitjen dhe administrimin e dokumentacionit që shqyrtohet dhe miratohet në mbledhjet e KKTU-së. Për sa më sipër,në zbatim të përcaktimeve mbi distancat sipas VKM-së Nr.408/2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" të ndryshuar,institucioni jonë nuk do të vijoje me procedurat për lëshimin e Dokumentit të Lejes së Lejes së Ndërtimit,pas u arritur dakortësia përkatëse në rastin..... Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,mbetemi në dispozicion për çdo informacion të nevojshëm.	E plotë	Nuk ka
17	25.12.2025	Informacion dhe ankesë	02.12.2025	Në përgjigje të shkresës suaj...Ju sqarojmë se; AZHT, e cila aktualisht funksionon si Sekretariat Teknik i KKTU-së,është krijuar me Vendimin Nr.725,datë 02.09.2015 "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të AZHT",i ndryshuar. Në mbështetje të VKM-së sipërcituar, kjo Agjenci ka kompetencë pranimin,përgatitjen dhe administrimin e dokumentacionit që shqyrtohet në mbledhjet e KKTU,me qëllim miratimin e lejeve të zhvillimit/ndërtimit nga KKTU. Për sa më lart,referuar kërkesës suaj,...pas verifikimeve përkatëse në databazë,në pronën.....,nuk evidentoi asnjë aplikim apo vendimmarrje të KKTU dhe në rast se do të ketë aplikime në këtë zonë ju bëjmë me dije se do të merrret në konsideratë kërkesa juaj.	E plotë	Nuk ka

18	25.11.2025	Kërkesë për informacion	05.12.2025	Në përgjigje të shkresës Suaj,...Ju bëjmë me dije si më poshtë vijon; Sikurse jeni në dijeni,KKTU me Vendimin...ka vendosur miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin.....vendimarrje e cila nuk është zbardhur ende. Në vijim ju sqarojmë se,Dokumenti i Rregullores së Veçantë është një dokument i cili shoqëron vendimin e KKTU-së,referuar dhe në zbatim të Ligjit Nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" të ndryshuar dhe akteve nënligjore në funksion të tij. Për sa më sipër,vendimin e sipërcituar sëbashku me dokumentacionin që e shoqëron,e konkretisht Hartën e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumentin e Rregullores së Veçantë do t'a gjeni të publikuar në faqen zyrtare të AZHT-së në rubrikën "Vendime KKT,pas përfundimit të procesit të zbardhjes. Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,mbetemi në dispozicion për çdo informacion të nevojshëm.	E plotë	Nuk ka
19	26.11.2025	Kërkesë informacioni	10.12.2025	Në përgjigje të kërkesës suaj.....,Ju sqarojmë se: Sikurse jeni në dijeni,AZHT kryen funksionet e Sekretariatit Teknik të KKTU-së dhe në përputhje me VKM-në Nr.725,datë 02.09.2015 "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të AZHT",i ndryshuar, ka kompetencën për të pranuar,përgatitur dhe administruar dokumentacionin tekniko-ligjor që shqyrtohet dhe miratohet në mbledhjet e KKTU. Për sa më sipër,pas zbardhjes së vendimit të sipërcituar,sëbashku me dokumentacionin që e shoqëron,do të mund t'a aksesoni në faqen zyrtare të AZHT-së www.azht.gov.al,në rubrikën "Vendime KKT". Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,mbetemi në dispozicion për çdo informacion apo dokumentacion të nevojshëm.	E plotë	Nuk ka
20	26.11.2025	Kërkesë për informacion			Në proces	Nuk ka
21	27.11.2025	Kërkesë-ankimore mbi procesin e kolaudimit dhe kërkesë për verifikim të plotë teknik të			Në proces	Nuk ka

22	27.11.2025	Kërkesë për anulimin e lejes së ndërtimit të miratuar me vendimin....			Në proces	Nuk ka
----	------------	---	--	--	-----------	--------